



copie. M. parashikuar
AL
Nr 4327 Prot
Dl. 21.12.2017



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR DURRËS

Gj.Petraq Çuri

Nr.Regj.449

Drejtuar:

Bashkisë së Qytetit Shijak



SHPALLJE

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës ka përfunduar gjykimi për çështjen penale me:

I/Të pandehur:

Esmaraldo Elezi

Akuza: Vepra penale "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal.

TABRIK
QRO

Me Vendimin nr.743, datë 04.12.2017 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur:

Deklarimin fajtor të të pandehurit Esmaraldo Elezi, për veprën penale të "Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve", parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, dhe dënimin e tij me pesë vjet burgim. Ky dënim do t'i filloj nga data e ekzekutimit të këtij vendimi.

Prova materiale lënda narkotike e llojit cannabis sativa, me një peshë prej 12.304 gramësh, konformë nenit 190 të KPrP, të asgjësohet, kurse pasaporta biometrike në emër të Esmaraldo Elezit, me nr.BD1533415 t'i kthehet të pandehurit.

Shpenzimet proceduriale gjatë hetimit paraprak në masën 61.000 lekë dhe ato gjyqësore në ngarkim të pandehurit.

Urdhërohet gjykata të kryejë pagesën e Av.Elona Hamzallari e caktuar kryesisht nga gjykata. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Për të pandehurin ky afat fillon nga e nesërmyja e ditës së njoftimit të këtij vendimi.

Kjo shpallje bëhet për efekt të njoftimit të vendimit të bërë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, të pandehurit në mungesë **Esmaraldo Muharrem Elezi**. Një kopje e kësaj shpalljeje afishohet në ambjentet e gjykatës dhe dy kopje dërgohen pranë **Bashkisë së Qytetit Shijak**, me qëllim që një kopje të afishohet në Këndin e Afishimit të shpalljeve pranë kësaj Bashkie dhe kopja tjetër të kthehet në Gjykatë me konfirmim afishimi nga ana e **Bashkisë së Qytetit Shijak**

(Të shënohet në shpallje data e afishimit).

Gjithashtu një kopje e kësaj shpalljeje të afishohet në faqen zyrtare të internetit të gjykatës.

Durrës, më datë 21.12.2017

JE MUNGËSE DHE



Bashkia Shijak
KRYETARI
Ardian Kokomeni

KRYESEKRETARE
MARSIDA SHËLLANI